



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-092
Prishtinë, më 9 shkurt 2017

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 9, 14, 15 DHE 27 SHKURT 2017**

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, i ndihmuar nga nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Kryetari i hapi punimet e kësaj seance plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Selvije Halimi, Abdyl Ymeri, Visar Ymeri, Murat Hoxha, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Shaip Muja dhe Njomza Emini, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Para se të procedohet me pikat e tjera të rendit të ditës, kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare për ta respektuar kohën e saktë të diskutimeve, të paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare u deklaruan se duhet të zbatohet Rregullorja e Kuvendit për kohën e caktuar për diskutim për secilën pikë të rendit të ditës gjatë shqyrtimit në seancë plenare.

Pastaj, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Zafir Berisha i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me respektimin e vendimeve të Qeverisë së Kosovës nga pushtetet lokale.

Ministri Ferat Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Haxhi Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me formimin e Komisionit për përcaktimit e shkallës së invalidëve të luftës së UÇK-së.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtrroi pyetje ministres për Dialog, Edita Tahiri, në lidhje me kodin telefonik shtetëror të Kosovës.

Ministrja Edita Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Salih Salihu i parashtrroi pyetje ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Memli Krasniqi, në lidhje me kompensimin e dëmeve të bujqve të shkaktuara nga importi fidanëve të infektuar.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Salih Salihu i parashtrroi pyetje ministrit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Memli Krasniqi, në lidhje me vështirësitë me të cilat po përballen prodhuesit e drithërave.

Ministri Memli Krasniqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje kryeministrit Isa Mustafa në lidhje me bisedimet e fundit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel.

Ministrja Edita Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Aida Dërguti i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me konkursin e specializantëve.

Ministrja Edita Tahiri iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Aida Dërguti i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Rexhep Selimi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me takimet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Zëvendëskryeministri Ramiz Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me emërimin e ministrit të Integriteteve Evropiane.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa në lidhje me përbërjen e Komisionit Shtetëror për matjen e territorit të Republikës së Kosovës.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me realizimin e programit qeveritar në lëmin e ekonomisë.

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Faton Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me ndotjen e mjedisit në disa fshatra të komunës së Ferizajt.

Ministri Ferat Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 19 janar 2017.

* * *

Në vazhdim, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Zenun Pajaziti, propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika:

- Formimi i Komisionit ad hoc për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave,
- Emërimi i deputetes Flora Brovina kryetare në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetit Nehat Baftiu.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi propozimin e kryetarit të GP të PDK-së që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pikat e lartshënuara.

4. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e mëparshme.

Ai e ftoi deputetin Ismajl Kurteshi që ta paraqes propozim-rezolutën në lidhje me organizimin e arsimit parashkollor, parafillor dhe parauniversitar në Kosovë pas interpelancës me ministrin Arsim Bajrami.

Deputeti Ismajl Kurteshi e paraqiti tekstin e propozim-rezolutën prej 12 pikave, të harmonizuar edhe me grupet e tjera parlamentare dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 60,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Arsimi të shpallet interes nacional, ndërsa në funksion të kësaj të rritet buxheti për këtë sektor.
2. Të rritet llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi i performansës së të gjithë mësimdhënësve në nivel vendi dhe të bëhet kategorizimi i tyre sipas rezultateve të vlerësimit dhe sidomos sipas rezultateve të testimit të jashtëm të nxënësve të tyre.
3. Qeveria e Kosovës ta krijojë një fond të veçantë për ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësimdhënësve dhe një fond tjetër për arsimin parashkollor, me qëllim të sigurimit të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së nevojshme.
4. Të bëhet rishikimi i Kurrikulës, i planprogrameve dhe teksteve shkollore në përputhje me kushtet dhe rrethanat në Kosovë.
5. Të ndalohet përdorimi i teksteve shkollore me përmbajtje antikushtetuese.
6. MASHT-i ta iniciojë themelimin e një forumi gjithëpërfshirës nga deputetët, nga ekspertët e fushës së arsimit dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile për analizën e situatës në arsim dhe të propozojë rekomandime.
7. Të rikonceptohen tekstet shkollore dhe të bëhet unifikimi i lëndëve shkencore.
8. MASHT-i të krijojë kushte të volitshme për organizimin e mësimi fakultativ.
9. Të zbatohet në plotëni Kontrata Kolektive.
10. Të rishikohet dhe të amendamentohet infrastrukture ligjore në fushën e arsimit.
11. Në rast të mospërbushjes së kriterëve për licencim, institucionet shkollore jashtë sistemit publik të mbyllen.
12. Ministri i Arsimit të raportojë para Kuvendit të Kosovës në çdo tre muaj për gjendjen në arsim.

5. Votimi i propozim-rezolutës lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryetari i njoftoi deputetët se edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën e mëparshme.

Ai e ftoi kryetarin e GP të LVV Glauk Konjufca ta paraqesë propozim-rezolutën.

Kryetari i GP të LVV, Glauk Konjufca, para deputetëve e paraqiti dhe arsyetoi propozim-rezolutën lidhur me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozim-rezolutën.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 19,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorumi të mjaftueshëm për vendimmarrje.

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga grupet parlamentare që t’i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë për Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së.

Grupet parlamentare i propozuan anëtarët e këtij komisioni, si në vijim:

GP i PDK-së e propozoi deputeten Blerta Deliu Kodra për kryesuese të komisionit dhe deputeten Xhevahire Izmaku për anëtare.

GP i LDK-së i propozoi deputetët Sadri Ferati dhe Agim Kikaj për anëtarë të komisionit.

GP i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk e propozoi asnjë anëtar për këtë komision.

GP i AAK-së e propozoi deputetin Lahi Brahimaj anëtar të Komisionit.

Deputetët e GP Lista serbe nuk ishin të pranishëm në seancë.

GP “Nisma për Kosovën” e propozoi deputetin Zafir Berisha anëtar të Komisionit dhe

GP “6+” e propozoi deputetin Kujtim Paqaku anëtar të Komisionit.

Pastaj, kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 49,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

7. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve

Kryesuesi i ftoi grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve.

Në vazhdim, grupet parlamentare i propozuan deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të këtij komisioni.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62 deputetë,
Kundër ----- 0 deputet,
Abstenime ----- 1 deputet.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve në këtë përbërje:

1. Hajdar Beqa, nga GP i PDK-së, kryetar,
2. Shqipe Pantina, nga GP i LVV-së, zv/kryetare e parë,
3., nga GP LS, zv/kryetar i dytë,
4. Xhevahire Izroku, nga GP i PDK-së, anëtare,
5. Sadri Ferati, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Agim Kika, nga GP i LDK-së, anëtar,
7. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së, anëtar,

8. Zafir Berisha , nga GP “Nisma për Kosovën”, anëtar dhe
9. Danush Ademi, nga GP “6+”, anëtar.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur për Media duhet të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

8. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e kryetarit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e GP të PDK-së.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Deputetja Flora Brovina, nga Grupi Parlamentar i PDK-së, emërohet kryetare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetit Nehat Baftiu.

9. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit, zotit Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë

Kryesuesi i seancës i njoftoi deputetët se z. Rexhep Selimi, i mbështetur edhe nga 14 deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Isa Mustafa, në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Rexhep Selimi tha se kronologjia e ngjarjeve në Mitrovicën veriore dhe në komunat në veri të vendit, tregon se atje kishte një dinamikë të vazhdueshme të përkeqësimit të gjendjes së sigurisë. Pas djegies së pikave kufitare 1 dhe 31 dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Qeveria e atëhershme nuk ndërmoi asnjë masë të vetme për jetësimin e shtetit edhe në ato komuna, pra në komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Më 26 korrik të vitit 2011, me një veprim të paplanifikuar ose me një veprim të planifikuar që të dështojë, Qeveria e atëhershme ndërmoi një veprim policor që rezultoi me vdekjen e policit Enver Zymberi dhe me ngritjen e barrikadave që e bllokuan veriun e vendit për qarkullim në shumë rrugë e sheshe atje.

Prej atëherë e deri më sot, atje në vend që të shuheshin strukturat e sigurisë së Serbisë, me anë të negociatave dhe marrëveshje u liberalizuan ato dhe e ndanë policinë në baza etnike.

Prej atëherë e deri sot, atje nuk ka shtet as institucione të Republikës së Kosovës, edhe ato pak institucione, siç është Policia e Kosovës në Mitrovicën e veriut, pra kontrollohen më shumë nga Serbia se sa nga zinxhiri komandues i Policisë së Kosovës.

Pas të gjitha bisedimeve e marrëveshje në dëm të sovranitetit të Republikës, marrëveshje pas marrëveshjeje, Qeveria e Kosovës arriti deri te një marrëveshje edhe për ndarjen fizike të qytetit të Mitrovicës, respektivisht të Kosovës, siç është marrëveshja për ndërtimin e një pengese prej betoni në anën veriore të urës së lumit Ibër në mes të qytetit të Mitrovicës.

Si rrjedhojë, tensionimi i situatës lidhur me murin ngriti kërkua interpelancë të kryeministrit lidhur me situatën e krijuar në Mitrovicë më 9 dhjetor 2016, pra tash e 2 muaj.

Në ndërkohë, brenda afatit kohor kur do të duhej të rrënohej muri sipas vendimit të Kuvendit, më 14 janar Serbia e nisi edhe një linjë të re të qarkullimit të trenit Beograd - Mitrovicë.

Siç dihet ai tren u ndal në Rashkën e marrëveshjes së koalicionit, shumë larg para se të arrinte në territorin e Republikës sonë.

U proklamua shumë një retorikë e pakuptimtë se kush e ndali linjën e trenit Beograd-Mitrovicë në Rashkë. Por, kurrë Qeveria e Kosovës nuk dha shpjegime përse dhe me çfarë të drejte qarkullon treni i hekurudhave të Serbisë në një linjë tjetër, në atë Krlevë - Mitrovicë.

Përse për Qeverinë e Kosovës vetëm treni që vjen nga Beogradi qenka ilegal, por jo edhe ai që vjen nga Krleva?

Muri prej betonit në Mitrovicë, treni i linjës Beograd-Mitrovicë, krijimi i një klime të pasigurisë në vend me kërcënime dhe frikësime ndaj qytetarëve për luftë herë nga presidenti i Serbisë, e herë nga ai i Kosovës, duket qartë se janë skenarë të harmonizuar mirë në bashkëpunim në mes të qeverive të Serbisë dhe Kosovës.

Krijimi i një situatë të tillë dhe i skenarëve të luftës së ftohtë, e dëmton rënd shtetin e Kosovës. Dëmton rënd rolin e shqiptarëve në rajon. Dëmton rënd partneritetin me miqtë tanë perëndimorë, u krijon hapësirë të favorshme forcave antiperëndimore në Kosovë dhe, mbi të gjitha, rrënon të ardhme e sigurt të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, një rezolutë e re dhe implementimi i saj do të ishte fillim i një ndryshimi shumë të nevojshëm në kursin e ecjes së Kosovës. Diskutimi i plotë i deputetit Rexhep Selimi është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në lidhje me çështjet e ngritura në këtë interpelancë.

Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, tha se veriu i vendit të Kosovës është pjesë e Republikës së Kosovës, se qytetarët e katër komunave në veri, ashtu sikurse edhe qytetarët e të gjitha komunave të tjera janë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Problemet në veri të vendit, sikurse edhe në çdo pjesë të Republikës së Kosovës duhet t'i zgjidhim mbi bazë ligjore, me mirëkuptim dhe komunikim me qytetarët.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetin territorial të shtetit tonë, ta ruajnë stabilitetin e brendshëm përballë provokimeve destabilizuese që erdhën nga sjelljet e Serbisë.

Me sjellje dhe përgjegjësi shtetërore u ndal treni me parulla provokuese i nisur nga Beogradi, në marrëveshje me kryetarin e Komunës së Mitrovicës së veriut dhe me përfaqësuesit serbë nga radhët e deputetëve dhe ministrave në institucioneve të Kosovës, si dhe me përkrahjen ndërkombëtare arritëm marrëveshje për rrënimin e murit ndarës dhe për ndërtimin e një sheshi, sipas ligjeve dhe standardeve të përcaktuara.

Në të gjitha rastet, përgjigjja jonë ishte institucionale dhe e vendosur në koordinim të plotë me të gjitha institucionet shtetërore, me presidentin e vendit dhe me kryetarin e Kuvendit.

Këtë të diel, më 5 shkurt, hoqëm murin ilegal në Mitrovicë, me një proces të brendshëm të bisedimeve mes Qeverisë dhe autoriteteve komunale të pjesës veriore të Mitrovicës.

Janë dy probleme, të cilat e ngarkojnë jo vetëm situatën në veri të vendit, por edhe në tërë vendin. Është shtrirja akoma e gjerë e strukturave paralele serbe në shumë komuna, jo vetëm me shumicë serbe, por formalisht edhe me ato me shumicë shqiptare, në institucione shëndetësore dhe kompani publike dhe është ndikim i drejtpërdrejtë i Qeverisë së Serbisë në deputetët e Kuvendit dhe anëtarët e Qeverisë nga radhët e Listës serbe, prandaj mendoj se kjo çështje duhet të shtrohet në mënyrë integrale dhe jo vetëm si çështje e 4 komunave të veriut, asaj të Leposaviqit, Zubin-Potokut, Zveçanit dhe pjesës veriore të Mitrovicës, por si problem i tendencave që Serbia të ushtrojë edhe më tutje ndikim në vendin tonë.

Sa i përket veriut, Qeveria e Kosovës do të vazhdojë angazhimet për të konsoliduar më tej sovranitetin shtetëror në pjesën veriore të vendit.

Me marrëveshjen për kufirin është arritur që autoritetet shtetërore të Kosovës të vendosen në dy pika kufitare në veri, të cilat ishin sulmuar dhe djegur kur Kosova e shpalli pavarësinë në vitin 2008. Këto pika gjenden aty ku është kufiri shtetëror i Kosovës me Serbinë.

Kosova ka arritur të shtrijë sovranitetin e saj në veri të vendit në këto fusha: në fusha të sigurisë, ku Policia e Kosovës vepron nga viti 2014, në fushën e Doganave nga viti 2012, në fushën e Administratës Tatimore.

Kosova ka vendosur të gjitha ministritë dhe agjencitë shtetërore që kanë veprimtari lokale në këtë pjesë të vendit.

Këto zhvillime pozitive në veri të vendit krijojnë mundësi për përmirësimin e jetës së qytetarëve, të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të qytetarëve dhe komuniteteve.

Qeveria e Kosovës vlerëson kontributin e dhënë nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për tejkalimin e tensioneve të krijuara dhe ndaljen e provokimeve destabilizuese nga Serbia.

Qeveria e Kosovës dhe të gjitha institucionet shtetërore kanë zotësinë për t'iu përgjigjur çfarëdo sfide me të cilën ne do të ballafaqohemi. Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e kryeministrit Isa Mustafa.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Albin Kurti, në emër të GP LVV; Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, Qerim Bajrami, në emër të GP “6+” si dhe deputetët: Faton Topalli, Raif Qela, Vjosa Osmani-Sadriu, Rustem Berisha, Blerta Deliu-Kodra, Sadri Ferati, Ismajl Kurteshi, Ali Berisha, Enver Hoti, Abdyl Ymeri, Anton Quni, Ilir Deda, Glauk Konjufca, Muhamet Mustafa, Emiljija Rexhepi, Adem Salihu, ministrja Edita Tahiri, Ganimete Musliu, Sabri Hamiti, Shpejtim Bulliqi, Beikm Haxhiu dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa iu përgjigj pyetjeve të deputetëve që u ngritën gjatë kësaj interpelance.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për ta hedhur në votim propozim-rezolutën. Votimi i saj shtyhet për seancën e radhës

* * *

10. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues, në lidhje me përgjegjësinë për Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se z. Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga tetë (8) deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Isa Mustafa në lidhje me përgjegjësinë për Ligjin e sigurimeve shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputeti Visar Ymeri tha se Qeveria e Republikës së Kosovës më 10 gusht të vitit 2016 ka marrë vendimin që të fillohet me mbledhjen e premieeve për sigurime shëndetësore dhe si datë për këtë fillim ishte caktuar 1 janari i vitit 2017. Por, Qeveria e Republikës e shtyri këtë datë për në verën e vitit 2017, më saktësisht, në korrik.

Vendimin për mbledhjen e premieeve Qeveria e Republikës së Kosovës e ka mbështetur në Ligjin për sigurime shëndetësore, respektivisht në nenin 12, paragrafi 1.

Në këtë kuptim, ligji e detyron Qeverinë për plotësimin e parakushteve përpara se të fillojë mbledhja e premieeve, e këto parakushte janë:

1. Grumbullimi i premieeve do të fillojë vetëm pasi që lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor, së bashku me deklaratën përkatëse financiare për atë vit fiskal, të jenë miratuar sipas nenit 14 të këtij ligji.
2. Është lista e shërbimeve pa pagesë, nga neni 7 i këtij ligji, të cilat do të jenë të definuara. Çmimi i çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor për atë vit fiskal të jetë i dakorduar.
3. Bashkëpagesa dhe nivelet e tjera të bashkëfinancimit të jenë të dakorduar.
4. Së paku 75% e të punësuarve në sektorin publik dhe në ndërmarrjet e regjistruara private dhe publiko-private me TVSH të deklaruar dhe me qarkullim më të madh se 50 mijë euro të kenë marrë kartelë të sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër të verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor, dhe
5. Së paku 75% të individëve që u përkasin kategorive të liruara t'u jepen kartelat e sigurimit shëndetësor ose mjet tjetër i verifikimit të statusit të regjistrimit në sigurimin shëndetësor.

Krijimi i këtyre parakushteve është i lidhur ngushtë me funksionalizimin e sistemit të informimit shëndetësor, i cili përfshin të gjitha modalitetet, duke filluar nga: lista e shërbimeve, lista e çmimeve për çdo shërbim, licencimi i rregullt për çdo punonjës shëndetësor në gjithë Republikën e Kosovës, funksionalizimi i odave të punonjësve shëndetësorë, që duhet të bëjnë këtë licencim, regjistrimi i personelit shëndetësor, regjistrimi i pacientëve, sistemi i referimit, udhërrëfyesit klinikë, regjistri i barnave dhe siguria e të dhënave.

Është thënë disa herë se grumbullimi i fondeve duhet të fillojë disa muaj para ofrimit të shërbimeve, me argumentimin se fondi paska nevojë për akumulim të mjeteve financiare para se të fillojë mirëfilli me afrimin e shërbimeve.

Në kushtet kur Kosova është vendi më i varfër në Evropë, me jetëgjatësinë mesatare më të ulët në Evropë, me investimin më të ulët në sektorin shëndetësor në raport me produktin e brendshëm bruto, si dhe i vetmi vend në rajon pa sigurime shëndetësore, qasja joserioze jo vetëm që nuk siguron të drejtën elementare për të marrë shërbime shëndetësore, që bën pjesë në të drejta themelore të njeriut, por thellon varfërinë, duke pasur impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit.

Ligji i miratuar në vitin 2014 për sigurime shëndetësore nuk i plotësonte disa parime bazë, atë të universalitetit, të solidaritetit dhe, mbi të gjitha, të barazisë që sigurohet nga progresiviteti si dhe lë hapësirë shumë të madhe për keqmenaxhim sa i takon favorizimit klientelist të interesave private në shërbimet e sektorit me kapital jopublik.

Pa analizën e mirëfilltë të punës së deritashme në implementimin e SISH-it, nuk mund të kemi fillim të punës serioze të sigurimeve shëndetësore.

Para se të fillojë mbledhja e parave të qytetarëve për sigurime, ata publikisht duhet të njoftohen për përfitime që do të kenë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria duhet të garantojnë, në bazë të një dinamike kohore, se cilat do të jenë benefitet për paratë që i paguajnë qytetarët. Diskutimi i plotë i deputetit Visar Ymeri është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në lidhje me çështjet e ngritura në këtë interpelancë.

Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, tha se zhvillimi i shëndetësisë është prioritet i përcaktuar me programin tonë qeverisës. Lipsen investime kapitale, sidomos në pajisje dhe aparaturë të teknologjisë sa më të re, furnizimi i rregullt me barna dhe material tjetër, si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit mjekësor dhe personelit ndihmës.

Investimet në shëndetësi dhe në arsim janë investime produktive, prandaj në periudhën e ardhshme me prioritet do të kalohen investimet nga infrastruktura rrugore në këto fusha, të

cilat drejtpërdrejt e determinojnë zhvillimin ekonomik dhe social. Përpos Fondit për Sigurime Shëndetësore do t'i shfrytëzojmë edhe mjetet e tjera, të cilat mund të shfrytëzohen për këto destinime zhvillimore.

Themelimi i fondit dhe aktivizimi i tij shihet si një çështje tepër e rëndësishme dhe në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës qysh nga fillimi i mandatit para dy vjetëve, ka filluar t'i përmbushë të gjitha detyrat për ta aktivizuar sistemin e sigurimeve shëndetësore si komponentë tepër e rëndësishme e shëndetësisë në Kosovë.

Kemi bërë përpjekje që të fillojmë me sigurime shëndetësore në fillim të këtij viti, qoftë edhe me një skemë fillestare të thjeshtë, e kemi përfunduar pjesën kryesore të përgatitjeve, por kemi vlerësuar se lipset edhe pak kohë në mënyrë që përgatitjet të jenë sa më të kompletuara. Ligji për sigurimet shëndetësore parasheh që Ministria e Shëndetësisë me akt nënligjor e përcakton datën e fillimit të mbledhjes së premieeve për fond. Ministria i ka propozuar Qeverisë miratimin e vendimit për fillimin e mbledhjes së premieeve dhe Qeveria, më 10 gusht vitit të kaluar, ka marrë vendim për fillimin e mbledhjes së premieeve për sigurimet shëndetësore të obligueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës nga 1 janari i këtij viti.

Ju informoj se në muajt e fundit të vitit 2016 kam organizuar dhe zhvilluar disa takime me ministrat që involvohen në çështjet e funksionalizimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore edhe me praninë e partnerëve ndërkombëtarë.

E kemi vlerësuar së bashku gjithë nivelin e përgatitjeve teknike dhe legale për funksionalizimin e fondit dhe mundësitë e mbledhjes së premieeve.

Ministria e Shëndetësisë ka punuar me dikasterët e tjerë të Qeverisë me një plan konkret të veprimit.

Sa i përket lartësisë së pagesave me ligj është paraparë që pagesat për fondin të ndahen në mënyrë proporcionale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, përkatësisht kjo lartësi prej 7%, që llogaritet në të ardhurat bruto, prej të cilave 3,5% i paguajnë punëmarrësit dhe 3,5% punëdhënësit.

Si përfundim, analizimi i rrethanave si dhe të gjitha rekomandimeve nga partnerët dhe ekspertët e brendshëm dhe ndërkombëtarë, si dhe të asociacioneve të bizneseve dhe odave ekonomike vendore dhe tjera, kanë qenë arsyet, të cilat kanë rezultuar me faktin se procesi për mbledhjen e premieeve është caktuar të fillojë nga data 1 korrik 2017.

Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e kryeministrit Isa Mustafa.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së; Hatim Baxhaku, në emër të GP të LDK-së; Besa Baftiu, në emër të GP të LVV-së; Ali Berisha, në emër të GP të AAK-së; Valdete Bajrami, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët: Beikm Haxhiu, Mirjeta Kalludra, Driton Çausi, Time Kadrijaj, Abdyl Ymeri, Shukrije Bytyqi, Shaip Muja, Zafir Berisha, Faton Topalli, ministri Imet Rrahmani, Luljeta Gutaj-Veseli, Visar Ymeri, Salihe Mustafa, Labinotë Demi-Murtezi, Fikrim Damka dhe Nehat Baftiu, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve që u ngritën gjatë kësaj interpelance.

Në fund, deputeti Visar Ymeri, në emër të propozuesit të interpelancës e paraqiti tekstin e propozim-rezolutës për miratim.

Kryetarët e grupeve parlamentare propozuan që të formohet një grup për harmonizimin e tekstit të propozuar.

Me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi e formoi Grupin për harmonizimit të tekstit të propozim-rezolutës në këtë përbërëje:Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Ali Berisha, Shukrije Bytyqi dhe Fikrim Damka.

Pas harmonizimit të tekstit të propozim-rezolutës, deputetja Besa Baftiu e paraqiti propozim-rezolutën për miratim.

Kryesuesi e hodhi në votim tekstin e propozim-rezolutës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Kërkojmë nga Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të përgjithshëm të fondeve të ndara për Sistemin e Informimit Shëndetësor - SISH prej fillimit të implementimit të projektit e deri në fund të muajit dhjetor 2016. Për këtë të përgatisë raport me shkrim për Kuvendin e Republikës së Kosovës,
2. Funkcionalizimi dhe shtrirja e plotë e Sistemit Informativ Shëndetësor me plan dhe kalendar publik,
3. Raportimi i ministrit të Shëndetësisë në Kuvend në baza të rregullta tremujore për funksionalizimin e Sistemit Informativ Shëndetësor,

4. Qeveria ta shqyrtojë mundësinë e rritjes së buxhetit në mënyrë të vazhdueshme për shërbimet shëndetësore, barnat dhe materialin harxhues deri në funksionalizimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësore,

5. Plotësimi i parakushteve të parapara me Ligjin për sigurimet shëndetësore para fillimit të mbledhjes së premieeve,

6. Publikimi i dokumenteve me qëllim informimin e publikut për çmimoren, kategoritë që përfshihen në pagesa dhe ato që lirohen.

5. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Në vazhdim të seancës kryesuesi e hodhi në votim propozim-rezolutën në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, mirëpo në mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk kaloi kjo propozim-rezolutë.

6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancën plenare të filluar më 9 shkurt 2017 grupet parlamentare kanë propozuar deputetë për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Kryesuesi e hodhi në votim për ta miratuar Komisionin ad hoc, por nuk kaloi për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje.

7. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë

Kryesuesi pasi që i njoftoi deputet se edhe për këtë çështje diskutimet kanë përfunduar e hodhi në votim propozim-rezolutën në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë e cila në mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk kaloi.

9. Debat parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, sipas kërkesës së deputetit Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë nënshkrues

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, zoti Daut Haradinaj, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë ka propozuar debat parlamentar lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës.

Kryesuesi e ftoi, z. Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, që në emër të propozuesit të çështjes ta merr fjalën.

Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, duke e paraqitur dhe arsyetuar kërkesën për këtë debat deklaroi se

transformimi i FSK-së është i domosdoshëm dhe se ky transformim duhet të bëhet në koordinim të plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me NATO-n.

Forcat e armatosura të Kosovës në asnjë rrethanë nuk duhet të konsiderohen rrezik për askënd, por përkundrazi, ato do të jenë partner të paqes dhe stabilitetit në rajon. Trupat tona do të jenë të popullit të Kosovës. FSK është po thuaj se tash e sa vite duke i pritur ndryshimet kushtetuese dhe këto ndryshime duhet të bëhen pikërisht në Kuvendin e Kosovës. Ky transformim është paraparë edhe me dokumente ndërkombëtare, në bazë të cilave është shpallur edhe pavarësia e Kosovës, ku edhe vetë deputetët serbë kanë marrë përgjegjësit e tyre.

Deputeti Haradinaj edhe një herë i ftoi deputetët e të gjitha grupeve parlamentare që të diskutojnë hapur në Kuvend, në të mirën e përbashkët që edhe Kosova ta përmbyllë një kapitull të fundit që e ka - krijimin e ushtrisë së saj. E nëse në rast se nuk mund të ndryshohet Kushtetuta, atëherë duhet të gjenden forma tjera. E formë dhe mundësi e thjeshtë është që nëpërmjet ligjit të bëhet transformimi dhe Kosova krahas shumë shteteve të rajonit ta ketë ushtrinë e saj.

Në përmbyllje të diskutimit të tij deputeti Haradinaj theksoi se si propozues i kësaj çështje ka paraparë tri pika të Rezolutës, të cilat në fund të diskutimeve do të mund të harmonizoheshin me të gjitha grupet parlamentare.

Kryesuesi në vazhdim të debatit fjalën ia dha ministrit të MFSK-së, z. Haki Demolli

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, diskutimin e tij e përqendroi në pasqyrimin e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete, të cilat Ministria e FSK-së i ka ndërmarrë lidhur me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës.

Këto veprime dhe aktiviteti sipas tij do të ndaheshin në tri shtylla:

1. Në veprimet që kanë të bëjnë me krijimin e bazës ligjore për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura,
2. Në planifikimin dhe përgatitjen për procesin e transformimit dhe
3. Në transparencën e Ministrisë së FSK-së dhe informimin e subjekteve relevante, politike, nacionale dhe ndërkombëtare për aktivitetet planifikuese të Ministrisë së FSK-së.

Në shtyllën e aktiviteteve të MFSK-së për krijimin e bazës ligjore për fillimin e procesit të transformimit, Ministria e FSK-së, i ka përgatitur amendamentet kushtetuese, të cilat nëpërmjet Qeverisë, respektivisht Kuvendit të Republikës së Kosovës ia ka proceduar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për të vlerësuar nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë apo liri të garantuar në Kapitullin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Bazuar në Programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2015, Qeveria e Kosovës këto amendamente ia ka dorëzuar për miratim Kryesisë së Kuvendit të Kosovës në qershorin e vitit 2015. Ministria e FSK-së, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur të Kosovës e ka hartuar edhe draft-ligjin për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosur, të cilin ia ka proceduar deri më tani dy herë Qeverisë së Kosovës, dhe atë në marsin e vitit 2015 dhe në tetorin e vitit 2016.

Në shtyllën e dytë, lidhshipi i Ministrisë së FSK-së, në bashkëpunim me organizatën amerikane DIRI, nga viti 2014 e deri më tani ka punuar në planifikimin e zhvillimit të procesit të transformimit, duke identifikuar 5 shtyllat kryesore të këtij procesi dhe atë kohëzgjatjen e procesit të transformimit, buxhetin e nevojshëm për këtë proces, shtimin e personelit gjatë tërë procesit, trajnimin dhe pajisjet individuale dhe kolektive të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura, si dhe infrastrukturën e nevojshme për vendosjen e forcave shpesh.

Te shtylla e tretë lidhur me transparencën e Ministrisë së FSK-së dhe informimin e subjekteve relevante, politike, nacionale dhe ndërkombëtare për aktivitetet planifikuese të ministrisë, MFSK është treguar tejet e vëmendshme që të bëjë transparente zhvillimet dhe rezultatet e arritura gjatë përgatitjes dhe planifikimit të procesit të transformimit. Kështu, në vazhdimësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë, për këto rezultate janë informuar: faktorët ndërkombëtarë, si ekipet këshilluese të NATO-s, faktorët vendorë, Presidenti i vendit, Kryeministri, Komisioni për Mbikëqyrjen e FSK-së, deputetët e komuniteteve pakicë joserbe, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës nga Lista serbe.

Në përmbyllje të diskutimit të tij ministri Demolli edhe një herë theksoi gatishmërinë e ministrisë, respektivisht Forcës së Sigurisë së Kosovës për ta filluar procesin e transformimit në Forcë të Armatosur të Kosovës.

Lidhur me temën e këtij debati parlamentar, diskutuan: Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Anton Quni, në emër të GP të LDK-së; Albi Kurti, në emër të GP LVV, Rustem Berisha, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”; Qerim Bajrami, në emër të GP të “6+”, si dhe deputetët: Agim Çeku, Nuredin Ibishi, Rexhep Selimi, Time Kadrijaj, Enver Hoti, Ismet Beqiri, Besim Beqaj, Teuta Haxhiu, Glauk Konjufca, Shukrije Bytyqi, Shukri Buja, kryeministri Isa Mustafa, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Sabri Hamiti, Fatmir Shurdhaj, Arben Gashi, Faton Topalli, Emilija Rexhepi, Doruntinë Maloku, Gëzim Kelmendi, Veton Berisha, Abdyl Ymeri, Raif Qela, Naim Fetahu dhe ministri Enver Hoxhaj, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Pas përfundimit të diskutimeve të debatit parlamentar në lidhje me Forcat e Sigurisë së Kosovës, kryetari e ftoi deputetin Daut Haradinaj të paraqesë propozim-rezolutën.

Daut Haradinaj në cilësinë e propozuesit të debatit parlamentar e lexoi Propozim-rezolutën e harmonizuar nga të gjitha grupet parlamentare.

Kryetari më pas e hodhi në votim këtë propozim-rezolutë

Në votim kanë marrë pjesë 68 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 68 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 0 deputetë.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me votë unanime nxori këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria e Kosovës autorizohet që sa më parë ta koordinojë dhe ta procedojë në Kuvendin e Kosovës për miratim Strategjinë për transformim të Forcave të Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës,
2. Duke shprehur solemnisht përkushtimin e paalternativë për integrimin në organizatën e paktit Veriatlantik, NATO, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat tjerë institucionalë ta bashkërendojnë angazhimin për harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta me NATO-n dhe SHBA-në për zhvillimin e kapaciteteve operacionale konform mandatit të ri të Forcave të Armatosura të Kosovës.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi ministren e Drejtësisë znj. Dhurata Hoxha, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, z. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale diskutuan: Selviqe Halimi në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe në emër GP të PDK-së, Armend Zemaj, në emër GP të LDK-së, Faton Topalli, në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Shukrije Bytyqi, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët Fatmir Xhelili dhe Nait Hasani diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari në fund të diskutimeve konstatoi se nuk kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi ministrin e Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror diskutuan: Daut Haradinaj në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme dhe Siguri, Fatmir Shurdhaj në emër GP të PDK-së, Anton Çuni, në emër GP të LDK-së, Faton Topalli, në emër të GP të LVV-së, Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së, Shukrije Bytyqi, në emër të GP “Nisma”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari në fund të diskutimeve konstatoi se nuk kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi kryetarin e komisionit, zotin Muhamet Mustafa, që në cilësinë e propozuesit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Muhamet Mustafa e paraqiti dhe arsyetojë strukturën dhe përmbajtjen e Projektligjit si dhe kërkoj nga deputetët që ta votojnë në parim.

Në vazhdim kryetari konstatoi se nuk ka të paraqitur për diskutim dhe se votimi do të bëhet kur të krijohet kuorumi për vendimmarrje.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi ministrin e Financave, z. Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës diskutuan: Safete Hadërgjonaj në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe në emër GP të PDK-së, Salih Morina, në emër GP të LDK-së, si dhe deputeti Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari në fund të diskutimeve konstatoi se nuk kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi ministren e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministrja e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndërmjetësim diskutuan: Selvije Halimi në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Nezir Çoçaj në emër GP të PDK-së, Armend Zemaj, në emër GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari në fund të diskutimeve konstatoi se nuk kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Kryetari e ftoi ministrin e Financave, z. Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave z. Avdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin në parim rreth këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës diskutuan: Zenun Pajaziti në emër GP të PDK-së, Agim Kikaj, në emër GP të LDK-së, deputetët: Fatmir Xhelili, Muhamet Mustafa dhe Shpejtim Bulliqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari në fund të diskutimeve konstatoi se nuk kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

* * *

E mërkurë, 15 shkurt

Vazhdimi i mbledhjes plenare

10. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoj nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 67 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 2 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoj nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 66 deputetë,

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56 deputetë,
Kundër ----- 10 deputetë,
Abstenime ----- 0 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoj nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 63 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 58 deputetë,
Kundër ----- 3 deputetë,
Abstenime ----- 2 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Votimi i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoi nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 70 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 70 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 0 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndërmjetësim.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoi nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 75 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 9 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e kaluar andaj do të procedohet me votimin. Kryesuesi kërkoj nga deputetët të votojnë.

Në votim kanë marrë pjesë 63 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 0 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i Agjendës për Reforma Evropiane

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Integritet Evropiane e ka shqyrtuar këtë agjendë dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e saj.

Kryetari e ftoi ministren e Integritimeve Evropiane znj. Mimoza Ahmetaj, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Agjendën .

Ministrja e Integritimeve Evropiane znj. Mimoza Ahmetaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen e Agjendës për Reforma Evropiane. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për Agjendën për Reforma Evropiane.

Lidhur me Agjendën për Reforma Evropiane diskutuan: Njomza Emini në emër të Komisionit FunkSIONAL për Integritime Evropiane dhe në emër GP të LDK-së, Fatmir Xhelili në emër GP të PDK-së, Donika Kadaj Bujupi, në emër të GP të LVV-së, Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, Enver Hoti, në emër të GP “Nisma”, Duda Balje, në emër të GP “6+”, ministrja Hykmete Bajrami, deputetët: Shqipe Pantine, Teuta Haxhiu, Muhamet Mustafa, Faton Topalli, Ismet Beqiri, Daut Haradinaj, Ismail Kurteshi, Mytahir Haskuka, Glauk Konjufca, Besa Gaxherri, Shaip Muja, Zenun Pajaziti dhe ministrja Mimoza Ahmetaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim Agjendën për Reforma Evropiane.

Në votim kanë marrë pjesë 65 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64 deputetë,
Kundër ----- 0 deputetë,
Abstenime ----- 1 deputetë.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Agjenda për Reforma Evropiane.

17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi z. Veton Berisha, që në emër të Komisionit FunkSIONAL të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit me rekomandime.

Z. Berisha e paraqiti të plotë raportin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, së bashku me rekomandimet.

Lidhur me raportin dhe rekomandimet diskutuan: Emelija Rexhepi, në emër të GP të PDK-së, Kimete Bytyqi, në emër të GP të LDK-së, Puhije Demaku, në emër të GP të VV, Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, Myfera Shinik, në emër të GP “6+” , Enver Hoti, në emër të GP të “Nisma” dhe deputetët: Qerim Bajrami, Faton Topalli, Shaip Muja, Ganimete Musliu, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Armend Zemaj, si dhe Ministrat: Enver Hoxhaj dhe Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për ta hedhur në votim raportin nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Vazhdojmë në seancën tjetër me pikatë e papërfunduara të rendit të ditës.

* * *

E hënë, 27 shkurt 2017

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Seancën e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

Kryesuesi procedoi me pikat e rendit të ditës, të pa papërfunduara nga seanca e mëparshme, si në vijim:

1. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e datës 15 shkurt 2017.

Ai e hodhi në votim raportin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim për mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

2. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e njërit prej kandidatëve të propozuar.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

Deputeti Armend Zemaj e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit.

Kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për formimin e Komisionit votues.

Kuvendi, me propozimin e grupeve parlamentare, mori këtë

V E N D I M

Për formimin e Komisionit votues, në këtë përbërje:

1. Blerta Deliu-Kodrda, nga GP i PDK-së,
2. Armend Zemaj, nga GP i LDK-së,
3. Besa Baftiu, nga GP i LVV,
4. Lahi Brahimaj, nga GP i AAK-së,
5. Shkukrije Bytyqi, nga GP “Nisma”,
6. Qerim Bajrami, nga GP “6+”.

Deputeti Armend Zemaj propozoi që kjo pikë dhe pika në vazhdim për zgjedhjen e një anëtari për Bordin e Ankesave për Media të votohen për një herë.

Kuvendi e miratoi propozimin e deputetit Armend Zemaj dhe vendosi që procedurat për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera dhe për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave të zhvillohen përnjëherë.

Kryesuesi e ftoi Komisionin votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehët dhe deputetët, një nga një, që të votojnë për kandidatët e propozuar nga komisionet përkatëse.

Pas zhvillimit të procedurave të votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komuniteteve tjera.

Raportin e Komisionit votues e paraqiti deputetja Blerta Deliu-Kodra.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 91 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 10 fletëvotime.

Kandidatja Shadije Gërguri i ka fituar 11 vota,
Kandidati Qerim Fazliji i ka fituar 70 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehët, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Z. Qerim Fazliji zgjidhet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës nga radhët e komuniteteve tjera, me mandat pesë (5) vjeçar.

Raportin e Komisionit votues për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave e paraqiti deputetja Blerta Deliu-Kodra.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 91 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 3 fletëvotime.

Kandidatja Dua Kadriu ka fituar 58 vota,
Kandidati Mentor Hoxha ka fituar 30 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votim të fshehët, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Znj. Dua Kadriu zgjidhet anëtare e Bordit për Ankesa të Mediave, me mandat tre (3) vjeçar.

4. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Ai e hodhi në votim propozim-rezolutën e propozuar nga GP i LVV në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 25,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

5. Votimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në seancën plenare më 15 shkurt 2017 grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

GP i Lëvizjes Vetëvendosje nuk e ka propozuar anëtarin e komisionit.

GP Lista serbe nuk e ka propozuar një deputet për zëvendës kryesues të parë të komisionit.

Ai e hodhi në votim propozimet për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 53,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

6. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Ai e hodhi në votim propozim-rezolutën e propozuar nga GP i LVV në lidhje me situatën e krijuar në Mitrovicë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 29,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 6.

Kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

7. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje kryeministrit Isa Mustafa në lidhje me bisedimet në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me mbylljen e vendkalimit për këmbësor në magjistralen Prishtinë-Pejë në afërsi të Kazermës “Adem Jashari”.

Ministri Lutfi Zharku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me respektimin e kriterëve ligjore nga ana institucioneve arsimore për regjistrimin e nxënësve dhe studentëve..

Ministri Arsim Bajrami nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me kriteret e papërshtatshme për fitimin e të drejtës në pension.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ali Berisha i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me mosfunktionimin e spitalit të Vushtrrisë përkundrejt investimeve milionëshe.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Kimete Bytyqi i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me mungesën e repartit të Onkologjisë në regjionin e Prizrenit.

Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Enver Hoti i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me numrin e zëvendës-ministrave në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Lirije Kajtazi i parashtrroi pyetje ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, në lidhje me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Visar Ymeri i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me çështjen e Minierës së Sibovcit dhe shfrytëzimin e thëngjillit nga kjo minierë.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Mytaher i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me zbatimin e urdhëresës së gjykatës për gërmimet tek vendi xhamia e Ibrit.
Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Imet Rrahmani, në lidhje me fondin për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike.
Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, në lidhje me publikimin “Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit”.
Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 27 shkurt 2017, në orën 12:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*